



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 17.07.2008 ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N.225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Vlora Çitaku, Fatmire Berisha, Adem Hajdaraj, Donika Kadaj-Bujupi, Mark Krasniqi dhe Hestet Cakolli.
Munguan: Memli Krasniqi, dhe Dragan Dimiq

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu- kryetari i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndryshim e Plotësimin e Ligjit mbi Arkivat dhe Lëndën Arkivore**
- 4. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 03.07.2008 me ndryshimin e fjalisë së tij në diskutimin nën pikën të ndryshme.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndryshim e plotësim të Ligjit mbi Arkivat dhe lëndën Arkivore

Kryesuesi lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen lidhur me mënyrën e qasjes së punës lidhur me këtë projektligj.

Në vazhdim e njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me ofrimin e përkrahjes së USAID-it lidhur me amendamentimin e projektligjeve që janë në kompetencë të Komisionit.

Në vazhdim diskutuan anëtarët e Komisionit.

Donika Kadaj- Bujupi konsideron se si Komision do duhej të dalim me konstatimin se nritja e çështjes Departamentit në Agjencion, sipas projektligjit do t'i mundësonte ndërhyrjes së politikës në arkiva dhe se interferimi i politikave në administratë ndikon negativisht.

Ajo konsideron që kjo është një fushë e njeshme cila duhet të rregullohet në nivel të Drejtoratit e jo të Agjencionit.

Vlora Çitaku në diskutimin e saj tha se praktikat e vendeve në rajon do të mund të shërbenin për rregullimin e kësaj çështjeje.

Drita Kadriu tha se është me rëndësi që të funksionojë një Agjencion i cili merrret me faktografi pavarësisht nga ajo se si do të quhej Agjencion apo Drejtori ai duhet të me interes të gjerë për shumë veprimtari të institucioneve të ndryshme shtetërore dhe shoqërore, madje edhe me interes edhe për individët në raste të veçanta.

Heset Cakolli tha se çështja e ngritur rreth agjencionit është një çështje që duhet të shqyrtohet dhe debatohet.

Adem Hajdaraj tha se pasi çështja e arkivave është një çështje shumë e rëndësishme deh e ndjeshme për këtë qëllim mendon që komisioni do të duhet të organizojë një dëgjim publik.

Pas përfundimit të debatit rreth projektligjit për Ndryshim e Plotësimin e Ligjit mbi Arkivat dhe Lëndën Arkivore Komisioni nxorri këtë:

Përfundim

Referues për projektligjin për Ndryshim e Plotësimin e Ligjit mbi Arkivat dhe Lëndën Arkivore u caktua deputetja Donika Kadaj- Bujupi.

3. Të ndryshme

Drita Kadriu ngriti çështjen e publikimit në web të procesverbaleve të Komisionit të datës 18.06.08 dhe 23.06.2008 dhe cilat janë udhëhequr nga ajo dhe kërkoj sqarim nga administrata lidhur me këtë çështje..

Donika Kadaj kërkoj që Komisioni të merr një qëndrim rreth procesit të akreditimit të institucioneve të arsimit privat.

Kryesuesi, Agim Veliu, me këtë rast tha se Komisioni nuk ka ndonjë informacion konkret për këtë çështje, dhe do duhej të kërkojë nga Ministria informacione lidhur me procesin e licencimit si dhe Raportin e Këshillit Britanik për Akreditim. Komisioni u pajtua me këtë propozim dhe nxorri këtë :

Rekomandim

Komisioni i rekomandon Ministrisë së Arsimit që Komisionit t'ia dërgojë informacionet e sakta lidhur me procesin e akreditimit të bartësve të arsimit privat si dhe Raportin e Këshillit Britanik për Akreditim

Mbledhja përfundoi në orën 12,00

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Agim Veliu